

## **Komuna e Kamenicës: problemet kryesore dhe trendët buxhetor**

### **Hyrje**

1. Komuna e Kamenicës qeveriset nga koalicioni LDK-AAK, ku kryetari i Komunës vjen nga radhët e LDK, kurse nënkryetari dhe kryetari i Kuvendit Komunal vijnë nga AAK.
2. Kryetar i Komunës është Shaip Surdulli. Z. Surdulli është kryetari i cili ka qenë më së gjati në krye të një komune. Në fund të 2013 ai do t'i mbush 11 vite si kryetar Komune.<sup>1</sup> Për dy vite, kryetar i Komunës ka qenë Begzad Sinani nga PDK (2007-2009).
3. Kryetari Shaip Surdulli është duke u hetuar i akuzuar për një vepër të shkeljes së detyrës zyrtare. Kurse vetë z.Surdulli ka akuzuar ish kryetarin e Komunës Begzad Sinani (PDK) dhe ish-shefin e prokurimit se kanë keqpërdorur detyrën zyrtare.<sup>2</sup>
4. Hetimet ndaj dy kryetarëve të komunës për këto 13 vite kanë bërë që qytetarët e kësaj komune ta perceptojnë korrupsionin si shqetësim të madh në këtë komunë. Sipas një hulumtimi të UNDP, qytetarët e Komunës së Kamenicës kanë radhitur korrupsionin si problem mjaft shqetësues (10% e të anketuarve), madje më shqetësues se sa varfëria dhe standardi i ulët jetësor (9% e të anketuarve).<sup>3</sup> Papunësia mbetet problemi kryesor i qytetarëve të kësaj komune.

<sup>1</sup> Mandati i parë 2000-2002; Mandati i dytë 2002-2007; dhe Mandati i tretë 2009-2013.

<sup>2</sup> Gazeta Jeta ne Kosove. Dhjete kryetar Komunash te Akuzuar ose Denuar. 12 qershor 2013. Burimi: <http://gazetajnk.com/index.php?cid=1,3,5757>

<sup>3</sup> UNDP. Mozaiku i Kosovës 2012. Fq.71.

## Problemet kryesore të Komunës së Kamenicës

**1. Kundërmimi i shtratit të lumit në fshatrat Berivojcë dhe Koretin.** Lumi i cili kalon përmes fshatrave Berivojcë dhe Koretin, për shkak të ujërave të pakta gjatë verës dhe si pasojë e derdhjes së bërllokut dhe ujërave të zeza, është shndërruar në burim të kundërmimeve. Kjo më së shumti prek fshatin Koretin, fshatin më të madh të Komunës së Kamenicës, të cilin ky lum e përshkon në mes. Përkundër asaj se disa herë Komuna ka angazhuar kompani për pastrimin e anësoreve të shtratit të lumit nga bërlloku, asnjëherë nuk është tentuar që problemi të zgjidhet përfundimisht, qoftë duke vënë kontejnerë, qoftë duke investuar në gjetjen e një zgjidhjeje për mos derdhjen e ujërave të zeza në lum. Komuna e Kamenicës ka mbështetur banorët e këtyre fshatrave për rregullimin e kanalizimeve, mirëpo të gjitha këto kanalizime derdhen në lum. Shtrati i lumit “Kriva Reka” (lumit të “Shtrembër”) i cili fillon nga fshati Krilevë dhe vazhdon deri në fshatin Topanicë dhe më tej, është shndërruar i tëri pothuajse në vend për hedhjen e mbeturinave. Komuna e Kamenicës gjatë viteve të kaluara ka intervenuar vetëm në një pjesë të lumit, e cila kalon nëpër qytet.

Ndërtimi i një kolektori për ujërat e zeza është projekt i kushtueshëm, por komuna duhet të mendojë në këso zgjidhjes afatgjata. Sipas Planit Zhvillimor të Komunës së Kamenicës 2012-2022<sup>4</sup>, për evitimin e problemeve në të gjithë shtretërit e lumenjve të cilët kalojnë nëpër territorin e Komunës së Kamenicës, nevojitet një investim i përgjithshëm prej 6.9 milion eurosh.

Si zgjidhje tjetër më pak e kushtueshme, do të ishte edhe ndërtimi i gropave septike. Gropat septike, të ndërtuara se bashku me kanalizimet, në disa komuna janë treguar efikase dhe më pak të kushtueshme.<sup>5</sup> Por, gropat septike nuk mund të japin zgjidhje afatgjatë dhe në rast të ndërtimit duhet të jenë të ndërtuara në atë mënyrë e cila lejon lidhjen e tyre me impiantin e ujërave të zeza, projekt i cili duhet të filloj së zbatuari.

**2. Mos funksionimi i ujësjellësit në fshatin Koretin.** Në pjesën e dytë të 2009, kur Komuna qeverisej nga PDK dhe Begzad Sinani, Komuna kishte filluar projektin për shtrirjen e rrjetit të ujësjellësit në fshatin Koretin. Tenderi i ujësjellësit ishte dhënë në dy faza, ku

<sup>4</sup> Plani Zhvillimor i Komunës së Kamenicës 2012-2022, gusht 2012. Burimi: <http://kk.rks-gov.net/kamenice/getattachment/9c4dda53-1565-4ce5-939e-6c0d4a6a9d82/Plani-Zhvillimor-Komunal-2012-2022.aspx>

<sup>5</sup> Një shembull i tillë është Komuna e Junikut.

më 7 korrik 2009 Komuna ka nënshkruar kontratën për fazën e parë të ujësjellësit (97.683,73 €), kurse kontrata për fazën e dytë ishte nënshkruar më 25 shtator 2009 (185.634,34 €).<sup>6</sup> Në total, Komuna ka investuar 283.318 € për ujësjellësin e fshatit Koretin. Banorët e fshatit kanë me vetëiniciativë kanë vendosur që të paguajnë së paku 50€ për familje, shumica prej të cilëve kanë paguar këtë shumë. Punimet e filluara në verën e 2009 nuk u përfunduan për afro dy vite për shkak të vonesa në kryerjen e punimeve nga kompania fituese. Mirëpo, edhe pas përfundimit të punimeve banorët e këtij fshati nuk kanë ujë për shkak të mos funksionimit të ujësjellësit. Komuna e Kamenicës për mosfunksionimin e ujësjellësit fajin ia lë punimeve të dobëta të kryera nga ndërmarrja fituese “AREA”, mos pagesën nga qytetarët, keqpërdorimin e ujit si dhe burimet jo të mjaftueshme të ujit nga pusët e hapura për këtë ujësjellës. Me qëllim që mbi 283 mijë euro të shpenzuara të mos shkojnë huq dhe qytetarët të furnizohen me ujë të pijshëm, Komuna duhet të gjej mënyra për funksionalizimin e këtij ujësjellësi.

Në përgjithësi, qytetarët e Komunës së Kamenicës kanë treguar nivel mbi mesatar të kënaqshmërisë me furnizim me ujë të pijes. Rreth 45% e familjeve në këtë komunë janë të lidhura me rrjetin e ujësjellësit, por 49% e familjeve të lidhura me ujësjellës nuk kanë furnizim të rregullt me ujë të pijes.<sup>7</sup>

**3. Mungesa e objektit të shkollës së mesme në Rogoqicë dhe gjendja jo e mirë në shkollën “Metush Krasniqi”.** Në shkollën fillore “Metush Krasniqi” në Rogoqicë mësimi zhvillohet në tri ndërrime dhe ora mësimore zgjat 30 minuta. Kjo ngarkesë në oraret e mësimi ka ardhur për shkak se në këtë shkollë mësojnë nxënësit e shkollës së mesme dhe asaj fillore. Si rrjedhojë, përveç se ora mësimore është e shkurtër, edhe klasat janë të dëmtuara, gjendja sanitare në shkollë është jo e mirë, nxënësit nuk mundën të mbajnë orët praktike, fushat sportive janë të dëmtuara. Problem tjetër për rreth kësaj shkolle paraqesin edhe kafebaret e vendosura në afërsi të objektit të shkollës, të cilat shpeshherë janë burim i konflikteve në mes nxënësve. Shpeshherë nevojitet prezenca e pjesëtarëve të policisë për të mbajtur qetësinë në hapësirën për rreth kësaj shkolle. Ndërtimi i objektit të ri shkollor ishte premtim edhe në fushatat e mëparshme elektorale, por deri më tani nuk është bërë asgjë në këtë drejtim. Arsyetimi i Komunës për mos ndërtimin e objektit të ri është kostoja e lartë e ndërtimit të tij.

<sup>6</sup> Komisioni Rregullativ i Prokurorimit Publik. Burimi: <https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CitID=ViewNotices&ID=20026> dhe <https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CitID=ViewNotices&ID=23364>

<sup>7</sup> UNDP. Mozaiku i Kosovës 2012. Fq.72-73.

**4. Mbështetja e klubeve sportive.** Në sezonin 2012/2013, klubi i futbollit “Kamenica”, i cili bën gara në ligën e dytë të Kosovës, arriti suksese dhe ishte në prag të inkuadrimit në Ligën e Parë. Suksesi i klubit bëri që futbolla të ndiqej nga një numër i madh shikuesish, si dhe u krijua një mundësi për zhvillim të aktiviteteve sportive dhe një krenari me klubin e qytetit. “Kamenica” është klubi i vetëm i futbollit të madh në Kosovë për të cilin luajnë edhe pjesëtarë nga komuniteti serb. Përkundër asaj se Komuna e Kamenicës, përmes Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, ka mbështetur me shuma të vogla financiare klubin e futbollit “Kamenica”, prapë se prapë kjo mbështetje nuk është e mjaftueshme për të mbajtur në këmbë një klub të futbollit të madh. Njëjtë qëndron situata edhe me klubet tjera sportive. Klubi i atletikës “Rogana” është një ndër klubet më të suksesshme në nivel të Kosovës dhe së paku dy atlet të këtij klubi kanë arritur suksese ndërkombëtare. Komuna nuk ka mbështetur vazhdimisht këtë klub, por në baza *ad hoc*.

Me qëllim që të krijohet një vazhdimësi e mbështetjes dhe jo të ketë financime në baza ad-hoc, nevojitet që Komuna e Kamenicës të ketë një plan të detajuar për mbështetjen e klubeve më të suksesshme sportive. Nëse shikohet struktura e buxhetit të ndarë për Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, shihet se pjesa më e madhe e buxhetit të kësaj drejtorie destinohet për paga të zyrtarëve të Drejtorisë dhe shpenzime tjera komunale. Një përqindje e vogël e buxhetit të Drejtorisë shkon direkt si ndihmë në ekipet sportive apo grupet kulturore. Komuna duhet që të riorientojë këto fonde në drejtim të klubeve, e të shkurtojë fondet administrative të Drejtorisë.

**5. Mbeturinat në fshatin Hogosht.** Në dalje të fshatit Hogosht, rruga që lidh fshatrat malore të këtij fshati, ekziston një pjesë e madhe e gjelbëruar dhe ujëvarave natyrale, pjesë e cila shfrytëzohet nga banorët e këtij fshati dhe tërë komunës për piknik dhe rekreacion. Mirëpo, viteve të fundit, kjo hapësirë ka marrë pamje jo të mirë, për shkak të derdhjes së mbeturinave, sidomos mbeturinave ndërtimore. Kjo dukuri ka rrezikuar edhe potencialin e këtij lokaliteti për të zhvilluar turizmin malor.

Në Komunën e Kamenicës mbeturinat grumbullohen rregullisht vetëm në qytet dhe pjesërisht në fshatrat Ruboc, Berivojë, Koretin dhe Rogaqicë. Në mbi 85% të territorit të komunës mbeturinat hidhen kudo dhe nuk ekziston mbështetje institucionale për grumbullimin e tyre. Edhe sipas hulumtimeve të UNDP, qytetarët

e Kamenicës kanë treguar nivel mbi mesatar të paknaqshmërisë me grumbullimin e mbeturinave.<sup>8</sup>

Komuna e Kamenicës duhet të hartojë një plan për zgjidhjen e problemit të mbeturinave në fshatin Hogosht, me qëllim që kjo pjesë të shndërrohet në hapësirë turistike dhe rekreative. Në qershor të 2013, në prag të “takimeve të vendlindjes” të cilat mbahen në Hogosht, Komuna kishte angazhuar eskavator për të larguar një pjesë të mbeturinave, mirëpo problemi edhe më tutje mbetet ngase qytetarët vazhdojnë të derdhin mbeturinat në atë pjesë.

## 6. Rregulli dhe profesionalizmi në arsimin fillor dhe të mesëm.

Gjendja në arsimin fillor dhe të mesëm në Komunën e Kamenicës nuk është e mirë. Përveç që mungojnë kushtet elementare për punë arsimore në disa lokalitete, shqetësim më të madh paraqet kualiteti i mësimdhënies dhe rregulli nëpër shkolla. Në sistemin arsimor të Komunës së Kamenicës mungojnë mësimdhënës të kualifikuar për një mori lëndësh, sidomos për lëndët anglisht, matematikë, fizikë, kimi, muzikë, art figurativ. Për këto pozita të mësimdhënies, sipas legjislacionit në fuqi, Komuna obligohet që të shpall konkurs për çdo fillim vit shkollor. Procesi i rekrutimit të mësimdhënësve është proces jo i drejtë dhe zakonisht përzgjidhen mësimdhënës të cilët janë të afërt me partinë në pushtet. Viteve të fundit si dukuri shqetësuese vërehet edhe mungesa e disiplinës nëpër shkolla, ku së paku dy mësimdhënës janë sulmuar nga nxënësit.

## 7. Madhësia e administratës së Komunës së Kamenicës.

Komuna e Kamenicës ka gjithsejtë 222 të punësuar vetëm në administratë. Numri i të punësuarve në administratë ka shkuar duke u rritur pas zgjedhjeve të fundit, pavarësisht faktit se komuna e Kamenicës është më e vogël në territor dhe numër të popullsisë, pas ndarjes së një pjese të territorit të cilat i janë bashkangjitur komunës së re të Ranillugut dhe Komunës së Novobërdës.

Tab.1: Numri i shërbyesve civil në administratën e Kamenicës 2009-2012

Vitet	2009	2010	2011	2012
Numri i shërbyesve civil	184	177 ↓	206 ↑	222 ↑

Në bazë të një vendimi të Qeverisë së Kosovës nr.10/46 i datës 3 dhjetor 2008<sup>9</sup>, vendim i cili mbetet ende në fuqi, komunat të cilat

<sup>8</sup> UNDP. Mozaiku i Kosovës 2012. Fq.71.

<sup>9</sup> Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr: 10/46 I datës 03.12.2008. burimi: [http://kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet\\_e\\_Mbledhjes\\_se\\_46-te\\_te\\_Qeverise\\_2008.pdf](http://kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_Mbledhjes_se_46-te_te_Qeverise_2008.pdf)

kanë nën 100 mijë banorë duhet të kenë të punësuar një shërbyes civil për 780 banorë. Në bazë të regjistrimit të fundit të popullsisë, Kamenica ka 35.600 banorë dhe në bazë të formulës së mësipërme do të duhej të kishte maksimum 113 shërbyes civil. Kjo do të thotë se Kamenica ka një staf administrativ prej 109 punonjësve më shumë se që e lejon vendimi i Qeverisë. Vetëm Mitrovica, Peja, Prishtina dhe Gjlani kanë tejkalim më të madh të numrit të të punësuarve.

Komuna e Kamenicës duhet të ketë një plan për mënyrën e zvogëlimit të numrit të stafit të shërbyesve civil në Komunë. Kjo do të ndikonte në kursimin e mjeteve për paga, të cilat mund të orientohen në projekte tjera zhvillimore. Numri i zvogëluar i stafit administrativ, në bazë të vendimit të Qeverisë, nuk do të ndikoj në kualitetin e shërbimeve.


## Gjërat pozitive të cilat duhet mirëmbajtur

1. **Gjelbërimi.** Qyteti i Komunës së Kamenicës është një nga qytetet me sipërfaqen më të madhe të gjelbëruar brenda zonës urbane. Mirëpo, gjatë viteve të fundit, vërehen një tendencë e zvogëlimit të hapësirave të gjelbëruara në qytet. Komuna e Kamenicës ka prishur një pjesë të parkut përballë njërës nga ndërtesat publike, dhe ka betonizuar atë pjesë për ndërtimin e shtatores së një heroi. Po ashtu, Kuvendi Komunal i Kamenicës, me propozim të Kryetarit të Komunës, gjatë 2012 ka marrë vendim që të prishet një pjesë e parku të qytetit për t'i hap rrugë ndërtimit të objektit të ri të Bashkësisë Islame të Kosovës. Kafeteritë të cilat ndodhen në pjesën kryesore të qytetit kanë filluar shtrimin me kubëza të hapësirave publike përballë lokaleve të tyre, duke bërë që edhe më tepër të zvogëlohet hapësira e gjelbër. Komuna e Kamenicës duhet të angazhohet të ruaj dhe kultivoj hapësirat e gjelbëra në kuadër të qytetit.
2. **Toka bujqësore në “Rrafshin e Topanicës”.** Hapësira në mes të fshatit Koretin dhe “Kodrës së Crepit”, e cila njihet edhe si “Rrafshi i Topanicës” është tokë bujqësore. Mirëpo, viteve të fundit, komuna ka lejuar ndërtimet në tokë bujqësore. Ndërtimet e filluara në këtë zonë janë duke u zhvilluar pa ndonjë kriter dhe ekzistojnë lloje të ndryshme të ndërtimeve, si shtëpi banimi, garazhe për automekanik, depo ndërtimore, stacion të autobusëve, etj. Po ashtu, ndërtuesit e ndryshëm janë duke aplikuar kritere të ndryshme sa i përket largësisë së ndërtimit nga rruga kryesore

magjistrale. Komuna e Kamenicës duhet të ndalojë ndërtimet në këtë pjesë ose të vendos rregull për standardet kryesore të ndërtimeve, si lloji i ndërtimit, largësia nga rruga magjistrale, etj.

## Trendet Buxhetore në Komunën e Kamenicës


Buxheti i Komunës së Kamenicës ka pasur një rritje të lehtë përgjatë këtyre viteve. Në vitin 2010, buxheti total i Komunës ishte 6 milion euro, kurse buxheti për vitin 2013 është 7.5 milion euro. Grafikoni më poshtë paraqet trendin e ndarjeve buxhetore përgjatë këtyre viteve:



Burimi: <http://www.institutigap.org/spendings/?kamenice/2013#/~kamenice>

Pjesa më e madhe e buxhetit dedikohet për paga. Siç mund të shihet edhe nga grafikoni i më poshtëm, në vitin 2013 mbi 70.7% e buxhetit do të shpenzohet në paga dhe mëditje, kurse 1.3 milion euro (apo 17%) destinohet për investime kapitale.

Figura 2. Buxheti i Komunës së Kamenicës- 2013



Trend i njëjtë i buxhetit pritet të jetë edhe për tri vitet në vazhdim (2014-2016). Në bazë të Kornizës Afatmesme Buxhetore të Komunës së Kamenicës për vitet 2014-2016, buxheti i kësaj komune do të jetë sipas tabelës më poshtë:

Tab.1: Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës së Kamenicës 2014-2016

Të hyrat	2014	2015	2016
Të hyrat totale	7.257.486,00	7.157.725,00	7.315.442,00
Të hyrat vetanake	934.500,00	962.535,00	981.786,00
Tatimi në pronë	290.000,00	300.000,00	307.000,00
Taksat komunale	394.500,00	384.500,00	394.500,00
<b>Shpenzimet</b>	<b>7.257.486,00</b>	<b>7.157.725,00</b>	<b>7.315.442,00</b>
Pagat dhe mëditjet	5.314.884,00	5.314.884,00	5.314.884,00
Mallrat dhe shërbimet	666.073,45	666.073,45	666.073,45
Subvencionet	166.000,00	196.000,00	196.000,00
Shpenzimet kapitale	977.878,55	842.767,55	1.000.484,55



Siç shihet nga tabela më sipër, investimet kapitale në Komunën e Kamenicës janë planifikuar me rënie, kurse kategoria e mallrave dhe shërbimeve parashihet të mbetet e njëjtë. Kjo ndodh për shkak të mbingarkesës së stafit të administratës me shërbyes civil.

Komuna e Kamenicës ka të hyra të ulëta buxhetore. Madje, sipas raportit të auditimit të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2012, Komuna e Kamenicës ka mangësi të shumta në sistemin e përlllogaritjes dhe arkëtimit të të hyrave vetanake, defekte të cilat i pamundësojnë komunës që të grumbulloj të hyrave në mënyrë më efikase.<sup>10</sup>

Për shkak të buxhetit të ulët për investime kapitale, Komuna e Kamenicës ka aplikuar një metodologji të bashkëfinancimit të projekteve me qytetarë. Për shembull, për shtrimin e një rruge me asfalt apo ujësjellësi, banorët e atij lokaliteti janë detyruar të paguajnë një pjesë të investimeve (e cila në shumicën e rasteve shkon deri në 30%). Problemi me këtë qasje të komunës është se nuk ka ndonjë kriter se cilat lokalitete (lagje) duhet të participojnë e cilat jo. Kjo bën që një pjesë e qytetarëve të tatimohen dyfish. Nëse komuna vazhdon me këtë metodologji, duhet të aprovohet një rregullore e cila vendos kriteret e bashkëfinancimit, me qëllim që qytetarët të sigurohen se do të trajtohen barabartë me rastin e investimeve.

---

<sup>10</sup> Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Raport Auditimi mbi Pasqyrat Financiare të Komunës së Kamenicës për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2012. Burimi: [http://oag-rks.org/repository/docs/Kamenica\\_Report\\_ALB\\_913799.pdf](http://oag-rks.org/repository/docs/Kamenica_Report_ALB_913799.pdf)

## **Metodologjia e hartimit të raportit**

Instituti GAP në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) janë aktiv në fushën e qeverisjes lokale dhe fushatave para zgjedhore që nga zgjedhjet lokale të 2007. Përgjatë këtyre viteve, në bazë të punës hulumtuese dhe analitike, janë grumbulluar informata për nivelin e qeverisjes lokale, problemet kryesore dhe trendët buxhetore të komunave.

Identifikimi i problemeve kryesore në Komunën e Kamenicës është bërë përmes intervistave dhe fokus grupeve me njerëzit aktiv të komunës, si gazetarë, pjesëtarë të shoqërisë civile, etj. Të gjeturat e GAP janë mbështetur me të dhënat kuantitative të siguruara përmes anketës së zhvilluar nga BIRN.

Të gjeturat e GAP dhe BIRN janë krahasuar edhe me të dhënat e hulumtimeve më të mëdha që janë bërë viteve të fundit në nivel lokal, ai i UNDP (Mozaiku i Kosovës 2012-shërbimet publike dhe qeverisja lokale në fokus) dhe DEMI/USAID (Raport i Anketimit mbi Kënaqshmërinë e Qytetarëve me Shërbimet Komunale, 2012).



Instituti GAP është një Think-Tank i themeluar në tetor të 2007. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institute të ngjashme në shtetet perëndimore. GAP u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.